



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:093681

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05867509

Ac.nr.2057/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi, dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.A., nga fshati G., Komuna e Prizrenit, kundër paditurit B.A., nga fshati G., Komuna e Prizrenit, me objekt të kontestit kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.667/2015, të datës 23.05.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit R.A., nga fshati G., Komuna e Prizrenit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.667/2015, i datës 23.05.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.667/2015, të datës 23.05.2019, ka vendosur si në vijim: “I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesë padia e paditësit R.A. nga fshati G., Komuna e Prizrenit me të cilën ka kërkuar që të: “DETYROHET i padituri B.A. që t’ia kompenson dëmin e shkaktuar në shumën që do ta cakton eksperti me rastin e rrënimit të shtëpisë së tij të vjetër dhe ndërtimit të shtëpisë së re, në ngastrën kadastrale ... ZK G. e cila evidentohet në emër të A.A., në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm”. II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale”.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e atakuar C.nr.667/2015, të datës 23.05.2019, ta prish dhe ta kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose të njëjtin ta ndryshoj përkritazi me thëniet ankimore. I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 12.06.2015, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për kompensimin e dëmit. Paditësi në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka parashtruar së shtëpia e tij dhe shtëpia e të paditurit kanë qenë të ngjitura njëra me tjetrën dhe kanë qenë të ndërtuara para shumë kohe, ku kati i parë është i ndërtuar me gur, ndërsa kati i dytë tjegulla të lloqit, ndërsa i padituri me rastin e rrënimit të shtëpisë së tij i ka shkaktuar dëm paditësit pasi që shtëpia e paditësit ka pësuar plasaritje dhe qarje. Ka theksuar së për këtë veprim e ka lajmëruar inspektoratin e kuvendit komunal në Prizren, i cili ka ardhur dhe ka bërë konstatim në vendin e ngjarjes. I ka propozuar gjykatës që të detyrohet i padituri që paditësit t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shtëpi në shumën që do të caktoj eksperti përkatës, dhe t'i paguaj shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

I padituri përmes përgjigjes në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, me arsyetimin së i njëjti me rastin e rrënimit të shtëpisë së tij nuk i ka shkaktuar asnjë dëm paditësit.

Gjykata Themelore në Prizren, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykim C.nr.667/2015, të datës 23.05.2019, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar në këtë çështje juridike nuk është kontestues fakti se në ngastrën kadastrale ... ZK G. në të cilën tani gjendet shtëpia e re e të paditurit ka qenë shtëpia e vjetër dhe atë ngjitur dhe nën një kulm të përbashkët me shtëpinë e paditësit. Gjithashtu nuk është kontestues fakti se në ngastrën kadastrale ... ZK G. gjendet shtëpia e vjetër e paditësit, por kontestues ka qenë fakti se i padituri me rastin e ndërtimit të shtëpisë së re në ngastrën kadastrale ... konkretisht më rastin e rrënimit të shtëpisë së vjetër a i ka shkaktuar dëm paditësit dhe mbi këtë bazë a obligohet që dëmin e shkaktuar eventual t'ia kompensoj. Në këtë drejtim pas analizimit dhe vlerësimit të provave të administruara gjykata ka konstatuar se i padituri më rastin e rrënimit të shtëpisë së vjetër nuk i ka shkaktuar kurrfarë dëmi paditësit sepse rrënimin e ka bërë më kujdes të shtuar dhe maksimal për shkak të vjetërsisë së shtëpisë dhe se këtë rrënim e ka bërë me vegla pune të dorës (kazma, pajser etj), i cili rrënim është kryer duke filluar nga kulmi e deri në muret ndarëse të dy shtëpive dhe vetëm më pas është përdorur bageri, jo për të rrënuar, por për mbledhur dhe gjuajtur materialin ndërtimor të grumbulluar gjatë rrënimit, të cilat fakte vërtetohen posaçërisht nga dëgjimi i dëshmitarit K.M. të cilës provë gjykata ia fali besimin ngase është fqinj i tyre dhe ka marr pjesë në rrënimin e shtëpisë të paditurit dhe dëshmitarit N.Sh. të cilës provë gjykata plotësisht ia fali besimin për shkak se dëshmia e tij është autentike ngase ka marr pjesë në rrënimin e shtëpisë të paditurit ashtu që pas ndarjes fizike

të shtëpive të këtu palëve me bager ka grumbulluar mbeturinat e rrënimit dhe të njëjtat i ka gjuajtur në një përrua. Se i padituri me veprimet e tija gjatë rrënimit nuk i ka shkaktuar dëm paditësit pjesërisht vërtetohet dhe nga deklarata e vet paditësit i cili në deklarimin e tij nuk provon veprimet konkrete të paditurit me të cilat ka shkaktuar dëmin, ndërsa në anën tjetër nga të gjitha provat e administruara dhe posaçërisht nga shikimi i vendit të ngjarjes me ekspert të gjeodezisë dhe ndërtimtarisë gjykata vërteton faktin se shtëpia e paditësit është jashtëzakonisht e vjetër dhe se dëmtimet në të janë si pasojë e vjetërsisë së saj, andaj nga të dhënat e cekura më lartë gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke refuzuar kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar për shkak se paditësi nuk ka provuar faktin se shtëpia e tij është dëmtuar si pasojë e veprime të paditurit gjatë rrënimit të shtëpisë së tij të vjetër respektivisht ndërtimit të shtëpisë së re, pra në rastin konkret nuk plotësohen kushtet ligjore të nenit 136 të LMD i cili përcakton bazën e përgjegjësisë. Vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenin 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, dhe as në shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Pala paditëse në ankesë ka pretenduar për shkelje esenciale të dispozitave nga neni 182, paragrafi 2, pika n) të LPK-së, me arsyetimin së aktgjykimi ka mangësi për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyet e cekura dhe provat e administruara. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, ky pretendim është i pabazuar, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsye të qarta për faktet vendimtare dhe se të gjitha arsyet e paraqitura janë të qarta dhe mbi bazën e tyre është nxjerr përfundimi për çështjen objekt shqyrtimi. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme se si ka ardhur deri të përfundimi së kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Është i pa qëndrueshëm pretendimi ankimor i paditësit në këtë drejtim pasi që në rastin konkret me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata e shkallës së parë ka bërë marrjen e provës përmes këqyrjes në vend me ekspert të gjeodezisë dhe të ndërtimtarisë, si dhe me dëgjimin e dëshmitarëve. Në bazë të ekspertizës së ndërtimtarisë të datës 22.11.2017, të përpiluar nga eksperti F.K., nuk ka mundur të vërtetohet fakti së i padituri gjatë rrënimit të shtëpisë së tij të vjetër i ka shkaktuar dëm paditësit, pasi që sipas raportit të ekspertit objekti është mjaft i vjetër,

ku përdhesa është ndërtuar nga gurët të lidhur me lloq ndërsa kati i dytë nga qerpiqet prej dheut, ndërsa dëmtimet në mur dhe fasadë ku janë paraqitur edhe fotografit sipas kësaj ekspertize nuk është konstatuar së janë si rezultat i veprimit të të paditurit. Në rastin konkret i padituri nuk ka pasur vërejtje në ekspertizën e ndërtimitarisë e cila ishte nxjerr me qëllim të konstatimit të dëmit të pretenduar, nuk ka kërkuar plotësimin e saj dhe nuk ka kërkuar nxjerrjen e provës me ndonjë ekspertizë tjetër. Ndërsa në anën tjetër, gjykata e shkallës së parë përmes dëgjimit të dëshmitarëve K.M. dhe N.Sh., ka vërtetuar faktin së i padituri me rastin e rrënimit të shtëpisë së tij kishte vepruar me kujdes të shtuar dhe për shkak të vjetërsisë së shtëpisë këtë rrënim e ka bërë me vegla pune të dorës (kazma, pajser etj), i cili rrënim është kryer duke filluar nga kulmi e deri në muret ndarëse të dy shtëpive. Andaj, kjo gjykatë e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin e gjykatës së shkallës së parë së kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, pasi që i njëjti nuk e ka provuar faktin se shtëpia e tij është dëmtuar si pasojë e veprime të paditurit gjatë rrënimit të shtëpisë së tij të vjetër respektivisht ndërtimit të shtëpisë se re.

Po ashtu sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit së gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që në bazë të nenit 136 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, është paraparë së *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Sipas nenit 140 të këtij ligji përcaktohet së *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar në mënyrë të drejtë këtë dispozitë, pasi që ka konstatuar së paditësi nuk e ka provuar faktin se shtëpia e tij është dëmtuar si pasojë e veprimeve të të paditurit, dhe si rezultat i kësaj kërkesëpadia e paditësit është refuzuar si e pabazuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit 450 të LPK-së, pasi që pala paditëse e ka humbur procesin gjyqësor, ndërsa i paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2057/2021, datë 10.06.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci